



Fletë informacioni mbi subvencionet tarifore për kujdesin e fëmijëve në familje dhe në shkollë

Ju jeni banues në Bülach dhe e dërgoni fëmijën tuaj për përkujdesje në një çerdhe, në një familje për përkujdesje ditore ose në një qendër përkujdesjeje pas shkollës dhe dëshironi të aplikoni për subvencione tarifore. Bazat për llogaritjen e zbritjes tarifore janë **Urdhëresa e Kontributeve (BVO)** si dhe **Rregulloret Zbatuese (AB BVO)**. Këto dokumente i gjeni në adresën www.buelach.ch/bvo.

Bazat e përlllogaritjes

Baza për llogaritjen e kontributit të qytetit të Bülach është shuma e të ardhurave vjetore neto të prindërve që jetojnë në të njëjtën familje me fëmijët që do të marrin përkujdesjen. Të ardhurat totale llogariten në bazë të të ardhurave vjetore të renditura në numrat 100-164, 181 si dhe 188 të Deklaratës Tatimore.

Dokumentet e nevojshme

- Formulari i aplikimit i plotësuar plotësisht.
- Kopje e kontratës së përkujdesjes në çerdhe ose familje për përkujdesje ditore ose vërtetim i regjistrimit në përkujdesjen jashtëshkollore.
- Kopje e 6 fletëpagesave të fundit duke përfshirë të dhënat për pagën e muajit të 13-të.
- Në rast vetëpunësimi: Pasqyra e të ardhurave të vitit të kaluar

nëse është e mundur, duhet të dorëzohet si dokumente të bashkëngjitura edhe sa vijon:

- Deklaratë për çdo pagesë për ushqim dhe mirëmbajtje (sipas neneve 160 dhe 161 të Deklaratës Tatimore)
- Vërtetimi i çdo të ardhure nga sigurimet shoqërore dhe policat e tjera të sigurimit, si dhe pensioni për jetën në përputhje me nenet 130-143 të Deklaratës Tatimore (p.sh. pensioni IV, kompensimi për humbjen e të ardhurave nga siguri në rast papunësie, ndihmat ekonomike për fëmijët dhe familjen, të ardhurat e lejes së lindjes, paratë ditore)
- Lista e çdo të ardhure nga letrat me vlerë, kreditë dhe llotaritë në përputhje me nenet 150 dhe 151 të Deklaratës Tatimore.
- Çdo e ardhur nga qiraja nga një shtëpi private/pronë me kate ose prona të tjera në përputhje me nenet 180 dhe 188 të Deklaratës Tatimore.
- Deklarata për çdo të ardhur tjetër shtesë në përputhje me nenet 162-164 të Deklaratës Tatimore.
- Në rast se jeni në kërkim të një vendi pune: Regjistrimi në Shërbimin e Punësimi - RAV



Në rast se jeni gjatë shkollimit profesional: Dëshmi për profilin e shkollimit profesional, vërtetim

Tejkalimi i vlerës së pasurive

Nëse pasuritë e tatueshme sipas nenit 490 të Deklaratës Tatimore janë mbi 300,000 franga zvicerane, nuk keni të drejtë për subvencione – pavarësisht nga të ardhurat përkatëse.

Ndryshimet në informacion dhe kontrolli vjetor

- Prindërit janë të detyruar të raportojnë menjëherë çdo ndryshim në informacionin e dhënë në kërkesën e bërë në mënyrë që zbritja të mund të rillogaritet.
- Zbritjet e disponueshme kontrollohen një herë në vit dhe rregullohen nëse është e nevojshme. Prindërit do të marrin një shkrim që kërkon informacion aktual.
- Për të përcaktuar të drejtën për zbritje, Departamenti i Çështjeve Sociale dhe Shëndetësore i qytetit të Bülach është i autorizuar të marrë informacion në lidhje me të ardhurat përkatëse dhe pronat e tatueshme nga zyra e taksave Bülach, si dhe të dhëna personale nga Zyra e Banorëve të qytetit të Bülach.

Pagesa

Zbritjet për kujdesin në një çerdhe / në një familje për përkujdesje ditore / në një qendër përkujdesjeje pas shkollës
Ju paguani faturat e çerdes/ të familjes për përkujdesje ditore / të qendrës për përkujdesjeje pas shkollës. Më pas i dërgoni Departamentit Social dhe Shëndetësor të Bülach një kopje të faturës suaj dhe vërtetimin përkatës të pagesës në baza të rregullta (mujore deri në maksimum çdo 6 muaj). Kontributi i zbritjes më pas do të transferohet në llogarinë tuaj.

Zbritje për përkujdesjen e fëmijëve pas shkolle

Do të merrni një faturë mujore nga administrata e shkollës fillore minus zbritjen.

Dorëzimi i kërkesës:

Me anë të kërkesës online: [Aplikim për subvencione për kujdesin e fëmijëve në familje dhe shkollë \(www.buelach.ch\)](http://www.buelach.ch)

Me anë të E-mailit duke përfshirë dhe dokumentet e bashkëngjitura: bvo@buelach.ch

Me anë të postës:

Qyteti i Bülach

Çështjet Sociale dhe Shëndetësore

Urdhëresa Federale e Ndhmës – BVO

Allmendstrasse 6 8180 Bülach

Kontakt:

Tel. 044 863 15 43

E-mail: bvo@buelach.ch